REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.8705 Prot.

Lushnje, më 14 / 09 /2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

" PËR PAGESËN E PLOTË TË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRE PËR FAMILJEN E ZNJ.MAJLINDA KADRI DENEKU "

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Lushnje për vitin 2026 vazhdon programin "Subvecionimin e Qirasë" për familjet të cilat kanë rezultuar të pabanueshme nga Akt Konstatimi i mbajtur nga grupet e inspektimit të ngritura në Bashkinë Lushnje, duke i ofruar pagesën e plotë të qirasë për periudhën një vjeçare, sipas vlerës së tregut të lirë.

Në zbatim të nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 64, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", nenit 13 pika" i", nenit 16 pika "ii "e Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social". Familja e interesuar është paraqitur pranë zyrës së Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Lushnje dhe ka ndjekur të gjithë proçedurën për të përfituar nga programi i Subvecionimit të Qirasë për një vite.

Propozoj miratimin e projekt-vendimit për ti ardhur në ndihmë familjes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr.8705/1 prot. Lushnje, më 14.09.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 77 DATË 14/09/2026

" PËR PAGESËN E PLOTË TË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRE PËR FAMILJEN E ZNJ.MAJLINDA KADRI DENEKU"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Shërbimit Social dhe në mbështetje të nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 64, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", nenit 13 pika" i", nenit 16 pika "ii "e Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social",

PROPOZOJMË:

1. Përfitimin e pagesës së plotë të qirasë për periudhën një vjeçare, sipas vlerës së tregut të lirë, për familjet të cilat kanë rezultuar të pabanueshme nga Akt Konstatimi i mbajtur nga grupi i inspektimit të ngritur në Bashkinë Lushnje.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financë -Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social
Anila Cela

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16të ligjit nr. 22/2018	Adresa	Përberja familjare	Struktura e apartamentit	Qiraja mes. e apart. në treg per strukturen qe i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia
a	b	c	d	e	f	h	i	n
1	Majlinda Kadri Deneku	Banesa që paraqesin rrezik shembjeje;	"Njësia Administrative Allkaj"	1	1+1	16,000	-	16,000

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Cela